



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 108 datë 04.12.2025

PËR MIRATIMIN E NUMRIT, NIVELIT TË SHPËRBLIMEVE DHE ORËVE TË
PUNËS TË INSTRUKTOREVE TË JASHTËM TË KONTRAKTUAR NGA BASHKIA
PËRMET PËR VITIN 2026

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 04.12.2025, mbështetur në Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54 “Detyrat dhe kopetencat e Këshillit Bashkiak” i ndryshuar, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Ligji 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr.175 datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, VKM nr.511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit në institucionet shtetërore”, Udhëzimin Nr.21 datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrit të nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit parauniversitar” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë:

V E N D O S I:

1. Numri i instruktorëve të jashtëm të kontraktuar nga Bashkia Përmet për vitin 2026 të jetë 6 instruktorë, të cilët do punojnë me fëmijët në sektoret:
 - a) Artistik dhe sportiv
 - b) Shkencor
2. Pagesa e shpërblimeve të Instruktorëve të jashtëm për vitin 2026 do të bëhet deri në 24 orë punë në muaj.
3. Llogaritja e pagesës për instruktorët do të jetë e njëvlefshme me pagën mësimore për një orë punë mësimore, në bazë të ligjeve dhe vendimeve në fuqi.
4. Efektet financiare të këtij vendimi shtrihen nga 01.01.2026-31.12.2026.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE

KRYETAR
Anila DHIMITRI